

**Dokumenti mbi metodologjinë, politikat dhe
mënyrën e përmbushjes së “Kërkesës minimale për
instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime
të pranuarë”**

Banka e Shqipërisë

2023

Përmbajtja

1. Përmbledhje.....	3
2. Përlogaritja e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”	3
3. Rregullimet e mundshme për vlerën për rikapitalizim	4
3.1. Për të gjitha strategjitë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme	5
a. Rregullime të lidhura me madhësinë e bilancit të bankës.....	5
b. Rregullime të lidhura me normën shtesë të besimit të tregut	6
c. Rregullime të tjera të mundshme	6
3.2 Për strategjitë e transferimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.....	6
4. Periudha e ndërmjetme për përmbushjen e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”	8
5. Kalibrimi i “kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”	9

1. PËRMBLEDHJE

1. Në zbatim të nenit 13, pika 4 të rregullores nr.78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” (në vijim, rregullorja nr.78/2020), Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zhvillon dhe përditëson në mënyrë të rregullt metodologjitë dhe politikat e posaçme, në lidhje me përmbushjen e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” dhe i publikon ato.
2. Banka e Shqipërisë përcakton “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” për të siguruar që një bankë mban në çdo kohë instrumente të përshtatshëm në nivelin e mjaftueshëm që mundëson zbatimin e strategjisë së preferuar të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe të strategjisë alternative. Përmbushja e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” luan një rol kryesor në përmirësimin e aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në bankë, në përputhje me dispozitat e rregullores nr.31/2018 “Mbi përmbajtjen e planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”, e ndryshuar¹.
3. Gjithashtu, “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” shërben për plotësimin e objektivit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme mbi minimizimin e përdorimit të mbështetjes financiare të jashtëzakonshme publike² në rast të vendosjes së bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke siguruar që aksionarët dhe kreditorët e bankës të kontribuojnë në përthithjen e humbjeve dhe rikapitalizimin e saj. Kjo kërkesë minimale mbështet edhe qëndrueshmërinë dhe efikasitetin afatgjatë të sistemit financiar, duke promovuar transparencë, përgjegjshmëri dhe vlerësim më të mirë të rrezikut në sektorin bankar.
4. Banka e Shqipërisë përllogarit dhe komunikon çdo vit “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” si pjesë e ciklit vjetor të hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme për secilën bankë.

2. PËRLLOGARITJA E “KËRKESËS MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIME TË PRANUARA”

¹ Sipas aneksit 2 të rregullores, në kuadër të plotësimit të aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme banka duhet të përmbushë objektivin B në lidhje me plotësimin e “kapacitetit të përthithjes së humbjeve dhe rikapitalizimit”. Sipas këtij objekti, banka duhet të ruajë një nivel të mjaftueshëm burimesh financiare për përthithjen e humbjeve dhe, nëse është e zbatueshme, për rikapitalizimin e saj, që mundëson (i) mbulimin e të gjitha humbjeve në ndërhyrje të jashtëzakonshme, (ii) plotësimin e kushteve për vazhdimësinë e kryerjes së veprimtarive për të cilat banka është licencuar sipas ligjit për bankat, (iii) ruajtjen e besimit të tregut pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, si dhe (iv) vijueshmërinë e funksioneve kritike gjatë dhe pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

² Sipas nenit 20, të ligjit nr. 133/2016 “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

5. Në përputhje me rregulloren nr.78/2020, Banka e Shqipërisë përcakton “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, si shumë të vlerës për përthithjen e humbjeve dhe vlerës për rikapitalizim, për ato banka, të cilat, sipas planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme nuk do t’i nënshtrohen likuidimit të detyruar. *Vlera për përthithjen e humbjeve* pasqyron humbjet që banka duhet të jetë në gjendje të përthithë, deri në madhësinë e kërkesës rregullatore për kapital. *Vlera për rikapitalizim* është shuma e kapitalit që duhet të ruajë banka (pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme) për respektimin e kushteve për licencim dhe për vijueshmërinë e kryerjes së aktiviteteve për të cilat është licencuar. Bankat, të cilat sipas planit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme do t’i nënshtrohen likuidimit të detyruar, plotësojnë në parim vetëm kërkesën për vlerën për përthithjen e humbjeve, por nuk plotësojnë vlerën për rikapitalizim.
6. Banka e Shqipërisë përllogarit nivelin përfundimtar dhe nivelin e ndërmjetëm të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme. Në këtë drejtim, për përllogaritjen e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” në ciklin që fillon në një vit të caktuar (t), Banka e Shqipërisë përdor vendimet përfundimtare të kërkesave shtesë mbikëqyrëse (për kapital) të zbatueshme ose të komunikuara zyrtarisht në atë vit dhe të dhënat e bilancit të vitit paraardhës (t-1) ose të dhëna të mëvonshme kur konsiderohet e nevojshme për të adresuar një ndryshim të rëndësishëm në bankë, që mund të ketë ndodhur në rrethana të caktuara. Në rast se Banka e Shqipërisë vlerëson se ka një ndryshim të rëndësishëm në bankë, komunikon me bankën për të reflektuar ndryshimet përkatëse, sipas nevojës.
7. Në përputhje me nenin 6 të rregullores nr.78/2020, vlera për përthithjen e humbjeve përllogaritet si:

$$Vlera\ për\ përthithjen\ e\ humbjeve_t = Ekspozimet\ e\ ponderuara\ me\ rrezik_{dhjetor\ t-1} \\ *(norma\ e\ mjaftueshmërisë\ së\ kapitalit\ (12\%)_t + norma\ shtesë\ për\ kapital\ (\%)_t)$$

8. Në përputhje me nenin 7 të rregullores nr.78/2020, vlera për rikapitalizim përllogaritet si:

$$Vlera\ për\ rikapitalizim_t = Ekspozimet\ e\ ponderuara\ me\ rrezik_{dhjetor\ t-1} \\ *(Norma\ e\ mjaftueshmërisë\ së\ kapitalit\ (12\%)_t + norma\ shtesë\ për\ kapital\ (\%)_t)$$

9. Instrumentet e kapitalit bazë të nivelit të parë nuk mund të përdoren për të përmbushur njëkohësisht dy kërkesat rregullative të komunikuara nga Banka e Shqipërisë, atë për “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” dhe kërkesën për shtesat makroprudenciale. Sipas nenit 13, pika 3 të rregullores nr.78/2020, kapitali bazë i nivelit të parë përdoret fillimisht për të përmbushur “Kërkesën minimale për kapital dhe detyrime të pranuar” dhe më tej teprica mund të përdoret për të përmbushur kërkesat për shtesat makroprudenciale.

3. RREGULLIMET E MUNDSHME TË VLERËS PËR RIKAPITALIZIM

10. Në përputhje me nenin 7 të rregullores nr.78/2020, vlera për rikapitalizim mund të rritet ose të

zvogëlohet sipas vlerësimit të Bankës së Shqipërisë, në cilësinë e Autoritetit Mbikëqyrës dhe në cilësinë e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Në vijim paraqiten rregullimet e mundshme që mund të zbatohen ndaj *vlerës për rikapitalizim* të bankës.

3.1. Për të gjitha strategjitë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme

a. Rregullimet e lidhura me madhësinë e bilancit të bankës

11. Në përputhje me nenin 7, pika 5(a) të rregullores nr.78/2020, Banka e Shqipërisë mund të ndryshojë madhësinë e ekspozimeve të ponderuara me rrezik që përdoret për të llogaritur *vlerën për rikapitalizim*, duke marrë në konsideratë zvogëlimin e madhësisë së bilancit të bankës pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, planet detyruese të ristrukturimit të aktivitetit dhe masat e parashikuara në planet e rimëkëmbjes. Ky korrigjim i vlerës së ekspozimeve të ponderuara me rrezik bazohet në një analizë të detajuar për secilën bankë.
12. Metoda bazë për të marrë në konsideratë zvogëlimin e madhësisë së bilancit të bankës (pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme), është madhësia e rrezikut të kredisë në profilin e rrezikut total të bankës. Në një situatë të paaftësisë paguese të bankës, banka mund të ketë një madhësi bilanci më të vogël, krahasuar me madhësinë e bilancit që kishte gjatë periudhës së hartimit të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, veçanërisht nëse paaftësia paguese e bankës ka ndodhur për shkak të humbjeve nga rreziku i kredisë. Sa më i lartë të jetë kontributi i rrezikut të kredisë në kërkesën për kapital rregullator, aq më i madh është efekti i bilancit që mund të zbatohet Banka e Shqipërisë. Në çdo rast, korrigjimi i madhësisë së bilancit (zvogëlimi i tij) nuk duhet të kalojë nivelin prej 10% të totalit të aktiveve të bankës.
13. Tkurrrja e madhësisë së bilancit përmes uljes së investimeve (*disinvestment*) dhe shitjeve të parashikuara në planet e ristrukturimit, gjatë fazës, kur banka nuk është në paaftësi paguese, mund të merret në konsideratë për të korrigjuar (zvogëluar) *vlerën për rikapitalizim*. Shembuj të këtyre veprimeve përfshijnë heqjen nga bilanci të aktiveve që kanë një peshë të lartë të ponderimit me rrezik përmes veprimeve të detyrueshme të tkurrjes së bilancit. Nëse veprimet e parashikuara në planet e riskstrukturimit, para se banka të jetë në paaftësi paguese, janë ligjërisht të detyrueshme dhe me afate të qarta (të kufizuara) në kohë, Banka e Shqipërisë mund të marrë në konsideratë ndikimin e mundshëm të këtyre veprimeve në parametrat që përdoren për përcaktimin *vlerës për rikapitalizim* dhe rrjedhimisht edhe për “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”.
14. Banka e Shqipërisë mund të rregullojë në rënie madhësinë e bilancit të bankës, bazuar në masat e parashikuara në planet e rimëkëmbjes, vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe në varësi të kushteve të parashikuara në vijim.
15. Masat e rimëkëmbjes mund të merren në konsideratë (rast pas rasti) vetëm në rast se Banka e Shqipërisë i vlerëson veprimet për zbatimin e këtyre opsioneve si të besueshme, të realizueshme dhe menjëherë të zbatueshme në rast se banka ndodhet në ndërhyrjen e jashtëzakonshme dhe me një ndikim pozitiv në çdo skenar humbjeje. Banka e Shqipërisë mund të marrë në konsideratë opsionet e rimëkëmbjes për zvogëlimin e madhësisë së bilancit pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, deri në nivelin 5% të madhësisë së bilancit.

b. Rregullime të lidhura me normën shtesë të besimit të tregut

16. Vlera për rikapitalizim mund të korrigohet për lart (në rritje) nga një shumë e përshtatshme (shtesa për besimin e tregut) sipas nevojës për të siguruar që pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, banka të jetë e aftë të ruajë besimin e mjaftueshëm të tregut³. Kjo shtesë mundëson, që banka subjekt i ndërhyrjes së jashtëzakonshme të jetë e aftë të: (i) plotësojë kushtet për autorizim gjatë periudhës së ristrukturimit që pason ndërhyrjen e jashtëzakonshme, (ii) sigurojë ofrimin e funksioneve kritike dhe (iii) aksesojë fondet financiare në treg, pa përdorur mbështetjen e jashtëzakonshme financiare publike, në një horizont kohor prej një viti. Në fund të vitit të parë pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, pritet që zbatimi i planit për riorganizimin e aktivitetit tregtar⁴ që do të ndërmarë banka, të mund të përmirësojë ndjeshëm situatën financiare të bankës, në mënyrë që aksesimi i saj në tregjet financiare të mos jetë i vështirë.
17. Vlera shtesë (maksimale) për ruajtjen e besimit të tregut përllogaritet si diferenca ndërmjet shtesës së kombinuar makroprudenciale të kapitalit të përcaktuar sipas nenit 6 të rregullores “Për shtesat makroprudenciale të kapitalit” dhe kërkesës specifike kundërciklike të kapitalit, të përcaktuar në shkronjën “a”, pika 6 të nenit 11 në të njëjtën rregullore.

c. Rregullime të tjera të mundshme

18. Banka e Shqipërisë mund të korrigojë vlerën e kërkesës shtesë për kapital që duhet të mbajë banka, pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Në nenin 7 të rregullores nr.78/2020 parashikohen rregullime të mundshme në rritje ose në ulje të kërkesës shtesë për kapital që duhet të ruajë banka, pas zbatimit të strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
19. Përcaktimi i kërkesës shtesë për kapital që do të zbatohet në bankë, pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, kryhet rast pas rasti, pas konsultimit midis Autoritetit Mbikëqyrës dhe Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

3.2 Për strategjitë e transferimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme

20. Banka e Shqipërisë mund të rregullojë vlerën për rikapitalizim, përfshirë shtesën për besimin e tregut, për të pasqyruar ndikimin që vjen nga transferimi i aktiveve kur strategjia e ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikon zbatimin e instrumenteve të transferimit (përmes p.sh. shitjes së aktivitetit, krijimit të bankës urë dhe/ose zbatimit të instrumentit të ndarjes së aktiveve). Ky rregullim kryhet në bazë të një faktori shkallëzimi të aplikuar ndaj totalit të aktiveve, si një përafrim që pasqyron nevojat e rikapitalizimit të bankës pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme, bazuar në madhësinë e aktiveve që do të transferohen dhe/ose likuidohen, sipas procedurave të likuidimit të detyruar. Faktori i shkallëzimit është specifik për secilën bankë. Në këtë rast, *vlera për rikapitalizim* (pa përfshirë shtesën për besimin e tregut) përllogaritet si:

³ Sipas nenit 7, pika 6 të rregullores nr.78/2020 “Për kërkesën minimale për instrumentet e kapitalit rregullator dhe detyrimet e pranuar”

⁴ Në zbatim të nenit 38 të ligjit nr.133/2016 “Për rimëkmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në bankë, në Republikën e Shqipërisë”

*Vlera për rikapitalizim_t = Ekspozimet e ponderuara me rrezik të madhësisë së transferimit t-1
(norma e mjaftueshmërisë së kapitalit (12%)_t + norma shtesë për kapital (%))_t

21. Zbatimi i një rregullimi të tillë kërkon një vlerësim kritik dhe real të besueshmërisë dhe realizueshmërisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankën përkatëse, duke përdorur instrumentet e transferimit⁵. Si parakusht për zgjedhjen e instrumentit të shitjes së aktivitetit në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Banka e Shqipërisë vlerëson nëse janë përmbushur të gjitha kushtet për zbatimin e tij që në fazën e hartimit të planit. Këto kushte përfshijnë ndër të tjera, vlerësimin se banka ka standarde të larta në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit që mundësojnë prodhimin e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e bankës, analizën e tregut lidhur me blerësit e mundshëm dhe një analizë të thelluar të aftësisë së bankës për të mundësuar veçueshmërinë e njësive të aktivitetit të saj.
22. Gjithashtu, faktorët e rregullimit të *vlerës për rikapitalizim*, bazuar në madhësinë e transferimit për bankën, për të cilën supozohet zbatimi i një strategjie të transferimit të aktiveve, duhet të garantojnë se instrumentet e transferimit janë mjetet më të përshtatshme për arritjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme sipas strategjisë së preferuar, por dhe sipas strategjisë alternative të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.
23. Banka e Shqipërisë përshtat me karakteristikat specifike të bankës, faktorët e rregullimit të *vlerës për rikapitalizim*, bazuar në madhësinë e bilancit për t'u transferuar, brenda një intervali prej 10% të madhësisë së aktiveve, me një kufi të sipërm prej 20% dhe një kufi të poshtëm prej 10%. Faktorët e korrigjimit përcaktohen rast pas rasti, bazuar në kriteret që vlerësojnë aftësinë për të marketuar bankën dhe nevojat për kapital të saj, pas ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Këto kriteret përfshijnë:
 - a. Madhësinë e bankës, e matur nga totali i aktiveve;
 - b. Madhësinë e aktiveve me probleme, të matur nga raporti i ekspozimeve me probleme neto mbi totalin e aktiveve;
 - c. Madhësinë e depozitave, e matur nga raporti i depozitave të siguruara ndaj aktiveve totale ose nga raporti i depozitave totale ndaj aktiveve, sipas rastit;
 - d. Niveli i pasigurisë në vlerësimin e bankës, i matur nga raporti i aktiveve të Nivelit 3 ndaj totalit të aktiveve (një raport më i lartë i aktiveve të Nivelit 3 nënkupton një nivel më të ulët të transparencës ndaj blerësit).
24. Në rast se zbatimi i strategjisë së transferimit varet në një masë të madhe nga kushtet e tregut dhe/ose një palë e tretë, Banka e Shqipërisë harton një strategji alternative të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe "Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar" kalibrohet sipas rastit. Kjo qasje siguron që të dy strategjitë të mund të zbatohen në mënyrë të besueshme, nëse është e nevojshme, duke ndjekur detyrimin e Bankës së Shqipërisë për të siguruar aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme, të pavarur nga vendimet e palëve të treta ose rrethanat e jashtme.

⁵I referohet mundësisë për transferimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit të bankës, te një palë e tretë, bankë urë ose shoqëri për administrimin e aktiveve, nëse banka vendoset në ndërhyrje të jashtëzakonshme.

25. Nëse kalibrimi i “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” bazuar në strategjinë alternative të ndërhyrjes së jashtëzakonshme është më i lartë, ai është i nevojshëm për të siguruar që zbatimi i strategjisë së preferuar ose strategjisë alternative të jetë i realizueshëm në kohën, kur një bankë vlerësohet se është pranë paaftësisë paguese. Kështu, nëse si strategji e preferuar është përzgjedhur një strategji transferimi dhe si strategji alternative në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme parashikohet “rikapitalizimi nga brenda i bankës”, (në të cilën “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, është më e lartë kundrejt asaj në strategjinë e preferuar) “Kërkesa minimale për kapital dhe detyrime të pranuar” vendoset në përputhje me zbatimin e instrumentit të “rikapitalizimit nga brenda”.

4. PERIUDHA E NDËRMJETME PËR PËRMBUSHJEN E “KËRKESËS MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIME TË PRANUARA”

26. Neni 17 në rregulloren nr.78/2020 specifikon dispozitat e zbatueshme për periudhat e ndërmjetme të përmbushjes së “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, deri në dhjetor 2027. Në përputhje me këto dispozita Banka e Shqipërisë komunikon:

- a. përllogaritjet për nivelin e ndërmjetëm dhe përfundimtar të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” të kryera gjatë vitit t;
- b. nivelin e ndërmjetëm të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” që duhet të përmbushet gjatë vitit t+1;
- c. nivelin përfundimtar të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” që duhet të përmbushet gjatë vitit 2027.

27. Për vitin t, Banka e Shqipërisë përllogarit nivelin e ndërmjetëm të detyrueshëm të “Kërkesës minimale për kapital dhe detyrime të pranuar” për vitin t+1, duke shpërndarë në mënyrë progresive, “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, deri në fund të periudhës së ndërmjetme që përfundon në vitin 2027. Kjo përllogaritje bëhet sipas formulës në vijim:

$$NPR_t = \left(\frac{\text{Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar}_{2027}}{\text{Niveli i ndërmjetëm}_t} \right)^{\frac{1}{n}} - 1$$

ku:

- a. *NPR_t* është norma progresive e rritjes vjetore (%) për secilin vit, duke nisur nga viti 2022 deri në vitin 2027, që mundëson përmbushjen graduale të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”. Kjo normë rritjeje zbatohet ndaj nivelit të ndërmjetëm të “Kërkesës për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” që plotëson banka, në vitin e përllogaritjes t. Rezultati përbën nivelin e ndërmjetëm të “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar”, që duhet të plotësohet në vitin pasardhës, vitin t+1.
- b. “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” llogaritet si shuma e vlerës së paragrafit 7 dhe paragrafit 8 në këtë material dhe përbën nivelin përfundimtar që duhet të përmbushë banka brenda vitit 2027.
- c. Niveli i ndërmjetëm i “Kërkesës për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime

- të pranuar” për vitin t përbën nivelin e ndërmjetëm të komunikuar nga Banka e Shqipërisë që përmbushet në vitin t, përlllogaritur në bazë të bilancit të vitit t-1.
- d. *n* është numri i viteve për periudhën e ndërmjetme nga viti i përlllogaritjes t deri në vitin 2027.

5. KALIBRIMI I “KËRKESËS MINIMALE PËR INSTRUMENTE TË KAPITALIT RREGULLATOR DHE DETYRIME TË PRANUARA”

28. Banka e Shqipërisë komunikon “Kërkesën minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar, të shprehur si:
- raporti në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, të përlllogaritur sipas nenit 6, të rregullores “Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit”.
 - raporti në përqindje të të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës, të përlllogaritur sipas nenit 32, pika 2, të ligjit nr. 133/2016;
29. “Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, që duhet të përmbushë banka brenda vitit 2027, llogaritet si:

$$MREL_{EPR}_{2027} = \frac{\text{vlera e paragrafit 7} + \text{vlera e paragrafit 8}}{\text{ekspozimet te ponderuara me rrezik t-1}}$$

30. Kërkesa minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” në përqindje të të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës, që duhet të përmbushë banka brenda vitit 2027, llogaritet si:

$$MREL_{DET}_{2027} = \frac{\text{vlera e paragrafit 7} + \text{vlera e paragrafit 8}}{\text{detyrimet + instrumentet e kapitalit rregullator t-1}}$$

31. Niveli i ndërmjetëm i “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, për periudhën t, që duhet të përmbushet brenda periudhës t+1, llogaritet si:

$$MREL_{EPR}_t = \frac{\text{Vlera e perlllogaritur sipas paragrafit 27}}{\text{ekspozimet te ponderuara me rrezik}_{t-1}}$$

32. Niveli i ndërmjetëm i “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” në përqindje të të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit të bankës, për periudhën t, që duhet të përmbushet brenda periudhës t+1 llogaritet si:

$$MREL_{DET}_t = \frac{\text{Vlera e perlllogaritur sipas paragrafit 27}}{\text{detyrimet}_{t-1} + \text{instrumentet e kapitalit rregullator}_{t-1}}$$

33. Banka raporton çdo tremujor në Bankën e Shqipërisë, raportin e “Kërkesës minimale për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrime të pranuar” që përmbush nivelet e ndërmjetëm të përlllogaritur sipas paragrafit 31 dhe 32 më lart. Ky raport përlllogaritet si në vijim:

a. në përqindje të ekspozimeve të ponderuara me rrezik, për tremujorin përkatës

$$\text{MREL}_{\text{EPR}_{\text{tremujori}}} = \frac{\text{Kapaciteti total i detyrimeve te pranuarra dhe kapitalit rregullator}_{\text{tremujori}}}{\text{ekspozimet e ponderuara me rrezik}_{\text{tremujori}}}$$

b. në përqindje të të gjitha detyrimeve dhe instrumenteve të kapitalit, për tremujorin përkatës

$$\text{MREL}_{\text{DET}_{\text{tremujori}}} = \frac{\text{Kapaciteti total i detyrimeve te pranuarra dhe kapitalit rregullator}_{\text{tremujori}}}{\text{detyrimet}_{\text{tremujori}} + \text{instrumentet e kapitalit rregullator}_{\text{tremujori}}}$$